



**KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT**

**RAPORT MONITORIMI  
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT  
TË MINISTRISË SË DREJTËSISË  
2023**

[www.drejtesia.gov.al](http://www.drejtesia.gov.al)

**Përmbledhje Ekzekutive**

**Qasja vlerësuese**

**Metodologjia e monitorimit**

**Gjetjet e raportit**

**Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e Drejtësisë**

**Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit**

**Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun**

**Konkluzione dhe rekomandime**

**Hapa të tjera**

**Aneks**

## Lista e shkurtesave

---

ALBIS	Sistemi Shqiptar i Përmbarimit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
DPFD	Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë
IPA	Fondet për Projektet e Huaja
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MD	Ministria e Drejtësisë
NSSP	Paketa Kombëtare të Projekteve Strategjike
RNSH	Regjistri i Noterëve të Shqipërisë
SASPAK	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
NSSP	Paketa Kombëtare të Projekteve Strategjike
SND	Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë
SNKK	Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit
SSPP	<i>Single Project Pipeline</i> (Paketa e Projekteve)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## Përmbledhje Ekzekutive

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, është përgjegjëse dhe koordinuese për objektivat A.8 dhe A.9 të SNKK-së, që materializojnë forcimin e integritetit në administratën publike. Në zbatim të këtyre objektivëve, gjatë vitit 2020, Ministria e Drejtësisë hartoi dhe miratoi për së pari, dy instrumente me karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit: Planin e Integritetit të institucionit, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.333, datë 07.10.2020; dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020, me zbatimin e të cilës do të mundësonte replikimin e planeve të integritetit të institucionet e tjera të administratës qendrore me kompetenca ekzekutive, përkatësisht ministrinë fillimisht dhe varësitë e tyre në vijim.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuar në 12 fusha të përgjegjësisë institucionale të ministrisë.

Plani i Integritetit përmban gjithsej 112 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është fundi i vitit 2023.

Në përputhje me kreun 3, pika 3.1 të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Drejtësisë ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.


Raporti i monitorimit *Janar-Dhjetor 2023* për zbatimin e Planit të Integritetit, jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë për periudhën e kërkuar, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të njërive (drejtorive) të brendshme kontribuuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.

Për periudhën *Janar-Dhjetor 2023*, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 14 masa për të cilat është planifikuar kryerja e 28 aktiviteteve të shpërndara në tre objektiva, përkatësisht:

**Objektivi 1:** Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e Drejtësisë

**Objektivi 2:** Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

**Objektivi 3:** Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun.



Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 14 masash janë: zbatuar 13 masa dhe 1 masë ende mbetet në proces. 3 aktivitete nga 28 në total të parashikuara për ty kryer mbeten ende në proces zbatimi.

## Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit për periudhën *Janar-Dhjetor 2023*, për aktivitete dhe masa të kuadrit rregullator në MD, të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të organizimi dhe funksionimit të strukturave teknike të Ministrisë së Drejtësisë.

## Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 6 drejtorive dhe strukturave teknike në Ministrinë e Drejtësisë, për të cilat ka pasur të parashikuar masa për zbatim për periudhën *Janar-Dhjetor 2023*

dhe ecuri e deritanishme e tyre. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuuese.

## **Mbledhja dhe analiza e të dhënave**

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinator i Integritetit<sup>1</sup> të Ministrisë së Drejtësisë, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinator i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme (referohu: seksioni Nr. 2.2.6 të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet qendrore).

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuuese në këtë raport, të cilat janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave në Fushën e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore në Fushën e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumenta të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; rekomandime dhe konkluzione.

Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

---

<sup>1</sup> Koordinator i Integritetit është përfaqësues i Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion.

## Gjetjet e Raportit

### Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në Ministrinë e


#### Drejtësisë

Përmes këtij objektivi synohet përmirësimi dhe forcimi i integritetit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator.

Ky objektivi përmban një numër prej 6 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë (nëpërmjet Drejtorisë së Projekteve në Fushën e Drejtësisë); Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore në Fushën e Drejtësisë (nëpërmjet Drejtorisë për Çështjet e Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë); dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse (nëpërmjet Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve dhe të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar).

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 6 masa të zbatuar plotësisht.

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktiviteteve <b>pjesërisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete të <b>parealizuara</b>
Kuadër rregullator për integritetin	Masa/ Aktivitete	6	6	0	0



Për këtë periudhë monitorimi, *Janar-Dhjetor 2023*, evidentohet konsolidimi i stafit teknik e profesional të sektorit të përfaqësimit ligjor nga punonjës, pjesë të shërbimit civil dhe me eksperiencë të gjatë në këtë fushë. Konkretisht, përgjegjësi i sektorit është punonjës me 21 vite eksperiencë pune si jurist, dhe dy specialistët pjesë të sektorit, respektivisht me 14 dhe 3 vite ekperiencë pune si jurist. Institucioni përfaqësohet në mënyrë korrekte, profesionale dhe objektive në proceset gjyqësore ku është palë. Gjithashtu, përgjatë kësaj periudhe, stafi i përfaqësimit ligjor nuk ka pësuar ndryshime dhe nuk ka pasur kërkesa për ndërprerje të marrëdhënies së punës, duke garantuar vijimësi dhe efektivitet në punë. **(masa 1.3)**

Drejtorja për Çështjet e Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, kryen rregullisht procesin e inspektimeve mbështetur në ligjin e organizimin dhe funksionimit të institucionit dhe akteve të tjera rregullatore të fushës. **(Masa 1.4)**

Drejtorja e Programeve dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga SASPAK ka kryer konsultimin dhe priorizimin e projekt-propozimeve të dërguara nga institucionet e varësisë dhe organet e sistemit të drejtësisë, për tu propozuar në takimin vjetor të KSA-së me qëllim evidentimin e projekt-propozimeve prioritare në fushën e drejtësisë. Gjithashtu, manuali për raportimin periodik mbi ecurinë e projekteve në fushën e drejtësisë është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, nr. 583 datë 06.10.2023, me nr. prot. 5784/1 date 06.10.2023 "Për miratimin e rregullores për koordinimin e ndihmës së huaj".

Drejtorja ka kryer dakortësimin paraprak midis MD-së dhe institucioneve të varësisë për projekt-propozimet, përpara dërgimit të tyre për financime tek donatorët, sipas Paketës Kombëtare të Projekteve Strategjike; është hartuar Paketa e Projekteve/*Single Project Pipeline* (SSPP) për sektorin social në fushën e drejtësisë, me koordinimin midis institucioneve të varësisë dhe drejtorive pranë MD-së dhe u rishikuan fishat e projekteve së bashku me institucionet përkatëse.



Në funksion të këtij procesi, është dërguar Memo informuese për titullarin e institucionit, shkresa raportuese për SASPAK mbi listen e projekt-propozimeve prioritare. (**masa 1.7**)

Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë, me mbështetjen e projektit JUSTAL ka mundur hartëzimin e projekteve në Fushën e Drejtësisë duke krijuar një dokument në excel *Donor Map* i cili përmban (Titullin, Objektin, lidhja me SND, buxheti, kohëzgjatja, donatori, implementuesi dhe pika e kontaktit). Më tej, gjatë kësaj periudhe raportimi, janë realizuar 2 takime për koordinimin e projekteve me institucionet e varësisë:

1. 7 shkurt 2023, takim me personat përgjegjës për projektet, të institucioneve të varësisë dhe të pavarura të Sistemit të Drejtësisë, me objekt njohjen e pikave të kontaktit të institucioneve dhe njohjen e tyre me dokumentin *Donor Map*.
2. 31 maj 2023, takim me institucionet e varësisë, të pavaruara të sistemit të drejtësisë dhe Donatorë të ndyshëm të projekteve (ambasada, organizata, etj.) mbi prezantimin e dokumentit *Donor Map*.

Gjatë periudhës raportuese *Janar-Dhjetor 2023*, në datë 7 shkurt 2023, u zhvillua takim me personat përgjegjës për projektet e institucioneve të varësisë. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi projektet që janë duke u zbatuar, problematikat dhe sugjerimet e mundshme të personave përgjegjës. Impakti i këtij takimi ishte pozitiv në kuadër të rritjes së bashkëpunimit institucional që do të shërbejë raportimit sa më të saktë nga pikat e kontaktit mbi zbatimin e projekteve në fushën e drejtësisë. Gjithashtu, me qëllim shmangien e mbivendosjes së funksioneve koordinuese dhe raportuese të projekteve IPA, DPFID me ristrukturimin e fundit është ndarë në dy sektorë: Sektori i Programimit të projekteve IPA dhe donatorëve në Fushën e Drejtësisë dhe Sektori i Monitorimit të Projekteve IPA dhe donatorëve në Fushën e Drejtësisë, duke krijuar kështu një strukturë të dedikuar për ndjekjen dhe monitorimin e projekteve IPA dhe donatorë të tjerë. (**Masa 1.8**)

Gjatë periudhës raportuese *Janar-Dhjetor 2023*, janë kryer konsultime, me strukturat e institucionit dhe trajtuar me prioritet ndërhyrje dhe ndryshime në buxhetin e MD. (**Masa 1.9**)

Aktiviteti i fushës së prokurimeve publike është plotësisht i mbështetur në bashkëpunimin dhe evidentimin e aktiviteteve vjetore dhe në hartimin e një Plan-Buxheti dhe Regjistri të Parashikimeve të Prokurimeve të plotë e gjithëpërfshirës. Çmime preferenciale nuk aplikohen, pasi është i detyrueshëm përdorimi i Sistemit Dinamik, siç parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik. Çdo procedurë blerjeje zhvillohet online në Sistemin e Prokurimit Elektronik, duke bërë të mundur pjesëmarrje të gjerë operatorësh, konkurrencë dhe përdorim efektiv të fondeve (çmimi më i lirë). (**masa 1.10**)


Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

■ **Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit**

Përmes këtij objektivi synohet mirëfunksionimi i administratës së institucionit të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet vendosjes së linjave të qarta hierarkike, sanksionimit të një procedure të qartë të të gjitha proceseve të punës në njësitë e ministrisë, forcimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale të fushës si dhe rekrutimin e stafit në mungesë në përputhje me strukturën dhe organikën në fuqi të ministrisë.

Ky objektivi përmban një numër prej 7 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht hartimit të proceseve të punës (hartës); plotësisht të vakancave në sektorë dhe drejtori të MD; forcimit të kapaciteteve profesionale. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore në Fushën e Drejtësisë (nëpërmjet Drejtorisë për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor); dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse (nëpërmjet Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve). Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 6 masa të zbatuar plotësisht, dhe ndër to vetëm 1 masë zbatuar pjesërisht (në aneksin e raportit: masa 2.14). Ndër aktivitetet e këtij objektivi mbeten 3 ende në proces zbatimi, referuar në masat 2.3, 2.14 dhe 2.18.

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktiviteteve <b>pjesërisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete të <b>parealizuara</b>
Burime njerëzore të qëndrueshme dhe të kualifikuara	Masa/ Aktivitete	7	6	1	0



Për këtë periudhë monitorimi, *Janar-Dhjetor 2023*, për sa i përket analizës së nevojave për ndryshimet strukturore, sektori i burimeve njerëzore ka zhvilluar procesin bazuar në pikën 33, të VKM nr.893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore”, ku parashikohet se ndryshimet strukturore në çdo rast shoqërohen me relacionin përkatës, i cili ndër të tjera përmban arsyet e hollësishme të nevojës për ndryshime.

Procesi i analizës së nevojave është kryer duke u bazuar dhe në formularët e përshkrimit të punës të miratuar sipas VKM nr.142, datë 12.03.2014.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, me pasjen e një vakance në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, është publikuar ajo me shpalljen nr. 481, nga Departamenti i Administratës Publike. Janë kryer procedurat përkatëse e rekrutimit nga DAP dhe mbetet vetëm për tu dërguar akti i emërimit të personit të shëallur fitues. (**masa 2.2**).

Sektori i burimeve njerëzore ka kryer analizë mbi largimet nga puna të cilësuar si të paligjshme dhe ka rezultuar se, vendimet e largimit për punonjësit që janë aktualisht në listë pritje janë marrë në vitet 2004-2012 (11-19 vite më parë). Të dhënat mbi statusin e vendimeve gjyqësore përditësohen vazhdimisht, në varësi të ndryshimeve që pësojnë. Komisioni i Posaçëm i ngritur me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.110, datë 25.03.2022, merr në shqyrtim mundësinë për sistemimin e gjyqfituesve në vendet vakante ku plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme të pozicioneve të lira. Për këtë periudhë, nuk ka pasur raste të dhënies së vendimeve të largimit nga puna si rezultat i ecuresë disiplinore. Aktivitetet e parashikuara në këtë masë përkatësisht aktiviteti 2 është zbatuar pjesërisht dhe 1, 3, 4, 5, 6 janë të zbatuar plotësisht duke klasifikuar masën në masë të konsiderueshme të zbatuar. (**masa 2.3**)

Sa i përket vlerësimit vjetor të trajnimeve të kryera për punonjësit e Ministrisë të Drejtësisë, me shkresën nr.5546/2, datë 08.11.2023, Ministria e Drejtësisë ka përcjellë pranë ASPA nevojat për trajnim për vitin pasardhës, 2024 sipas kontributit të përcjellë nga të gjitha drejtoritë. Procesi i planifikimit të nevojave për trajnim zhvillohet bazuar në VKM nr.138, datë 12.03.2014 “Për Rregullat e Organizimit e të Funkcionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Trajnimit e Nëpunësve Civil”, të ndryshuar. Vlerësimi çdo 6 muaj i nevojave për trajnim të punonjësve reflektohet dhe në Formularin e Vlerësimit bazuar në VKM nr.109, datë 26.12.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”. Vlerësimi i nevojave për trajnim të punonjësve bëhet nga eprorët përkatës në kuadër të planifikimit vjetor të trajnimeve. Pas miratimit të Kalendarit të Trajnimeve nga ASPA punonjësit regjistrohen dhe ndjekin trajnimet përkatëse që vlerësohen të kenë ndikim në zhvillimin dhe përmirësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të lidhura me pozicionin e punës që mbajnë. Gjithashtu, përgjatë vitit kalendarik, ku kryhen dy vlerësime 6 mujore, eprorët e punonjësve bëjnë një rivlerësim të nevojave për trajnim i cili pasqyrohet në Ndarjen E: "Plani i zhvillimit profesional të nëpunësit" të formularit të vlerësimit bazuar në VKM nr.109, datë 26.12.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”. **(masa 2.6 e 2.7)**

Gjatë periudhës raportuese *Janar-Dhjetor* 2023, është kryer një analizë për nevojat e burimeve njerëzore për Strukturën e Monitorimit të Veprimtarisë Përmbartimore dhe Profesioneve të tjera të Lira. Aktualisht, vijon procesi i rekrutimit dhe plotësimeve të nevojshme për secilin sektor që ka mangësi dhe vijnë e kryhen trajnime për përdorimin e sistemit RNSH për stafin e sektorit. Për sa i përket trajnimeve mbi përdorimin e sistemit ALBIS, pritet të zhvillohen që nga momenti që ky sistem të jetë funksional. Kjo masë mbetet në vlerësimin e statusit pjesërisht i zbatuar. **(Masa 2.14)**

Stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit pas ndryshimit të strukturës në bazë të urdhrin të Kryeministrit, nr.196, datë 2.12.2022, një ndryshim në urdhrin nr.128, datë 8.11.2021, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, ka marrë pjesë në trajnimin "Hartimi Legjislativ" si dhe trajnime të tjera organizuar nga ASPA gjatë vitit 2023. Gjithashtu kriteret për këto pozicione janë shpallur dhe pritet përfundimi i procedurave përkatëse nga DAP, për plotësimin e vendeve vakante. **(Masa 2.17)**

Vlerësimi i nevojës për shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale dhe të Bashkëpunimit Gjqësor. Në bashkëpunim me DAP, rezulton të jetë kryer plotësimi i vendeve të lira në periudhën raportuese janar – dhjetor 2023. **(Masa 2.18)**

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

### ■ **Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun**


Përmes këtij objektivi synohet rritja dhe përmirësimi i transparencës dhe veprimtarisë së institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, kundrejt grupeve të interesit dhe publikut nëpërmjet

zbatimit dhe përdorimit të instrumenteve të të drejtës së informimit, konsultimit publik, të tjera forma të bashkëveprimit aktiv institucion të interesuar.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë kryesisht strukturat që prodhojnë raporte apo janë subjekt i auditimeve dhe kontrolleve, si dhe funksionet e koordinatorit të drejtës së informimit dhe ai i konsultimit publik.

Ky objektiv përmban vetëm 1 masë specifike të planifikuar dhe të zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht transparencës dhe informimit të publikut mbi aktivitetin dhe performancën e Ministrisë së Drejtësisë.

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023	Masa dhe aktivitete <b>plotësisht</b> të realizuara	Masa dhe aktiviteteve <b>pjesërisht</b> të realizuara	Masa dhe aktivitete të <b>prealizuara</b>
Transparencë e MD	Masa/ Aktivitete	1	1	0	0



Për këtë periudhë monitorimi, *Janar-Dhjetor 2023*, Ministria e Drejtësisë ka siguruar transparencë të plotë dhe të mirë për aktivitetin e saj operacional dhe organizativ. Në link:

<https://www.drejtësia.gov.al/publikime/> dhe <https://www.drejtësia.gov.al/transparenca/> mund të gjenden lehtësisht publikime dhe të dhëna. Drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë hartojnë dhe shpërndajnë e-buletine mujore, informative dhe ndërjegjësuere për grupet e interesuara dhe publikun e gjerë.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

## Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese *Janar-Dhjetor 2023*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezultojnë se:

- Ministria e Drejtësisë ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit.
- Ministria e Drejtësisë ka vijuar me plotësimin e vendeve të lira në drejtoritë teknike të saj dhe kualifikimin dhe trajnimin e stafit, në përputhje me analizën e nevojave të institucionit.
- Ka përmirësime në koordinimin dhe projektimin e nismave dhe iniciativave, për të siguruar bashkëpunime edhe për institucionet e varësisë së ministrisë.
- Janë rikthyer në detyrë ish-punonjës gjyq-fitues.
- Manuali për raportimin periodik mbi ecurinë e projekteve në fushën e drejtësisë është miratuar.
- Garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit [www.drejtësia.gov.al](http://www.drejtësia.gov.al).

## Hapa të tjera

- Të plotësohen të gjitha vakancat e evidentuara në çdo drejtori.
- Të kryhen trajnime mbi përdorimin e sistemit ALBIS.
- Të vijojë koordinimi dhe bashkëpunimi i drejtorive për raportimin mbi masat e Planit të Integritetit.

## Aneks

- Aneksi i raportimit të informacionit nga njësitë kontribuuese